



KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr.36, datë 27.11.2020

**Për miratimin e termave të referencës dhe kritereve të përzgjedhjes të
audituesit të brendshëm të specializuar,
për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave
për periudhën 2021 - 2024**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 7, pika 6, të nenit 17, pika 1 dhe të nenit 18 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

VENDOSI:

1. Të miratojë termat e referencës dhe kriteret e përzgjedhjes të audituesit të brendshëm të specializuar, për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për periudhën 2021-2024, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi nga strukturat përkatëse të Agjencisë.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar